



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 727 prot.

Tiranë, më 01.03.2019

Lënda: Strategjia e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe Strategjia për Menaxhimin e Riskut.

TË GJITHA DREJTORIVE TË AZHT

Bashkëlidhur do te gjeni Strategjinë e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe Strategjinë për Menaxhimin e Riskut, të cilat duhet të merren në mësime nga ana juaj gjatë ushtrimit të aktivitetit tuaj.



Konc.A.Koçi

F.Alimehmeti

Miratoi.E.Mala

A.Ramollari

B.Paci

Print.3kopje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

STRATEGJIA E AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Mars 2019

## PËRMBAJTJA

---

PËRMBAJTJA .....	2
1. HYRJE .....	3
1.1. Përshkrimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit .....	3
2. OBJEKTIVI DHE QËLLIMI .....	4
2.1. Objektivi i Përgjithshëm .....	4
3. SISTEMI E-LEJE .....	5
3.1. Sistemi "e-leje" – Prezantim i shkurtër i konceptit.....	5
3.2. Shërbimet që ofron sistemi e-leje.....	6
3.3. Koordinimi i punës nga AZHT.....	7
3.4. Risitë e Sistemit "e-leje" .....	8
4. STRATEGJIA NË VAZHDIMËSI .....	9
4.1. Çfarë synohet të arrihet.....	9
5. AKTIVITETET E MUNDSHME TE KONTROLLIT.....	9
5.1. Parimet e menaxhimit të riskut.....	9
5.2. Procesi i menaxhimit të riskut.....	9
5.3. Komponentët e menaxhimit të riskut.....	9
5.4. Metodologja e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.....	9
5.5. Faktorët, llojet dhe probabiliteti i riskut.....	9
5.6. Reagimi ndaj riskut.....	9
5.7. Rishikimi i riskut .....	9
5.8. Informimi dhe komunikimi.....	9

## HYRJE

### 1.1. Përshkrimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut të brendshëm të institucionit. Risku është pasiguria e rezultateve, apo një kërcënim negativ i veprimeve dhe ngjarjeve. Menaxhimi i mire i tij është element i rëndësishëm për realizimin e objektivave të institucionit. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe përgjigjen ndaj tyre.

Është e rëndësishme që drejtuesit në cdo nivel të pajisen me aftësitë e duhura në mënyrë që të njohin dhe menaxhojnë riskun. Cdo vit Institucioni harton Regjistrin e Riskut si një dokument orientues që ndihmon në evidentimin e risqeve në cdo drejtori.

Nëpërmjet kësaj strategjie Agjencia e Zhvillimit Të Territorit angazhohet që të kujdeset që risqet të identifikohen dhe të trajtohen në kohën e duhur, për te garantuar mirëfunksionimin e cdo hallke të Institucionit.

Në zbatim të Ligjit Nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe bazuar në VKM-në Nr. 725, datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar është ngritur Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), si sekretariat teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit.

Agjencia është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë dhe ka përgjegjësi për të:

- a) pranuar dokumentacionin për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Kombëtar të Territorit;
- b) organizuar mbledhjet e KKT-së;
- c) përgatitur dhe administruar dokumentacionin që shqyrtohet në to. Agjencia ka kompetencë dhe përgjegjësi për të organizuar, drejtuar dhe bashkërenduar procesin me autoritetet e tjera përgjegjëse, në nivel qendror dhe/ose vendor, me qëllim përgatitjen për shqyrtim dhe miratim të dokumenteve në kompetencë të KKT-së, sipas parimit të shërbimit me një ndalesë;
- ç) bashkëpunuar me njësitet e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera përgjegjëse për çështje të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, që janë në kompetencë të KKT-së;
- d) kryer komunikimin me palë të treta, për llogari të KKT-së;

- dh) komunikuar, për të shpërndarë dhe për të botuar, në sistemin elektronik të lejeve, vendimet dhe dokumentet e miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit;
- e) vënë në zbatim vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe për të monitoruar zbatimin e tyre nga njësitë e qeverisjes vendore e institucionet e tjera përgjegjëse;
- ë) kryer monitorimin e zhvillimeve në territor, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, për të përgatitur raportin përkatës dhe për të informuar Këshillin Kombëtar të Territorit e autoritetet e tjera që kanë përgjegjësi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- f) ofruar mbështetje ndaj njësive të qeverisjes vendore në proceset e tyre të zbatimit të instrumenteve të drejtimit të zhvillimit, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
- g) përfaqësuar Këshillin Kombëtar të Territorit, në të gjitha çështjet objekt shqyrtimi gjyqësor, që kanë lidhje me vendimet e miratuara dhe procedurat e kryera nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

## **2. OBJEKTIVI DHE QËLLIMI**

---

### **2.1. Objktivi i Përgjithshëm**

Qëllimi I hartimit të këtij dokumenti është identifikimi I riskut, vlerësimi i tij dhe me tej reduktimi ose eleminimi i riskut në mënyrë që të kufizohen kostot shoqërorë dhe financiare. Analiza e risqeve të ndryshme të institucionit duhet të bëhet në mënyrë të balancuar, duke pasur parasysh që identifikimi i një riku mund të ndikojë te një tjetër prandaj trajtimi i tyre duhet të jetë një proces i ndërthurur dhe të ketë ndërveprim në mënyrë që të arrihet një rezultat efikas. Në mënyrë që të realizohen qëllimet është e nevojshme të rritet niveli i ndërgjegjësimit të punonjësve të Institucionit, lidhur me cështjet e menaxhimit të Riskut, Përkufizimi I fushave të riskut dhe detyrave ne veprimtarinë e institucionit, monitorimit të vazhdueshëm, marrjen e masave për parandalim, eleminim ose pakësim te riskut me anë të kontrolleve të vazhdueshme

Agjencia udhëhiqet nga koncepti i "shërbimit me një ndalesë", gjë që nënkupton që çdo subjekt që kërkon një leje zhvillimi/ndërtimi pranë KKT-së, aplikon pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, dhe Agjencia koordinon procesin e pranimit, shqyrtimit, miratimit, leshimit të dokumentit të lejes, si dhe monitoron përputhshmërinë e kushteve të lejes me ndërtimin deri në

dhënen e certifikatës së përdorimit. Për këtë qëllim, është miratuar Urdhri i Kryeministrit Nr. 143, datë 03.11.2015 “Për ngritjen dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse për bashkërendimin e punës me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit (AZHT)“.

Që prej datës 1 shtator 2016, aplikimi, pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për leje leje zhvillimi / ndërtimi / certifikatë përdorimi, etj., dhe ndërveprimi institucional kryhet, ekskluzivisht, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

### **3. SISTEMI E-LEJE**

---

#### **3.1. Sistemi “e-leje” – Prezantim i shkurtër i konceptit**

Sistemi elektronik i lejeve “e-leje” ka filluar funksionimin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë më 20 Prill 2016. Gjatë periudhës 20 Prill 2016 – 31 Gusht 2016 aplikimi për leje ndërtimi apo çdo lloj kategorie tjetër leje që ka lidhje me ndërtimin (leje zhvillimi, deklarate paraprake, shtyrje afati etj) mund të bëhej në të dyja mënyrat, edhe në formë shkresore nëpërmjet depozitimit të kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues pranë bashkive përkatëse edhe nëpërmjet aplikimit online në sistemin elektronik të lejeve.

Në kuadër të projektit ‘Sistemi multifunksional i qendërzuar i lejeve të ndërtimit’, qytetarët kanë mundësinë të aplikojnë online për t'u pajisur me leje nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, në një faqe të dedikuar e cila emërtohet “e-leje”.

Aplikuesit, të cilët mund të janë individë ose subjekte, aplikojnë përmes portalit, duke plotësuar formularin e aplikimit dhe duke e dërguar atë drejt njërsë prej 61 Bashkive apo drejt AZHT, në varësi të llojit të ndërtimit apo punimit që do kryhet.

Ky aplikim i dërguar, më pas, merret në shqyrtim nga bashkia përkatëse apo AZHT. Për lëshimin e lejeve të ndërtimit, kërkohet edhe mendim-dhënia e institucioneve të tjera, në lidhje me vendin ku kërkohet të bëhet ndërtimi, me llojin e aplikimit, etj, në mënyrë që të realizohet parimi i “shërbimit me një ndalesë”.

Me implementimin e sistemit multifunksional të lejeve të ndërtimit, procedura është informatizuar në pothuajse të gjithë hallkat e punës që nga momenti i aplikimit të qytetarit deri në dhënien e lejes të ndërtimit apo lejeve të tjera.

Gjithsesi, synimi përfundimtar është që në procedurat që kryhen në përmjet sistemit e-leje, si dhe ndërveprimi institucional, të përfshijë edhe autoritete të tjera, të cilat për shkak të veprimtarisë që kryejnë, si dhe dokumentacionit që prodhojnë, nuk bëjnë ende pjesë në këtë proces.

### **3.2. Shërbimet që ofron sistemi e-leje**

Sistemi elektronik i lejeve të ndërtimit e-leje në fazën e parë të zhvillimit, do të mundëson 20 shërbime online, ndërkohë që tashmë, në vitin 2020 sistemi mundëson 26 shërbime online në fushën e ndërtimit, si:

#### **Llojet e shërbimeve (aplikimeve) që kryhen nëpërmjet sistemit e- leje:**

- Leje zhvillimi (Bashki , KKT)
- Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>; (Bashki , KKT)
- Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup>; (Bashki , KKT)
- Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>; (Bashki , KKT)
- Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup>; (Bashki , KKT)
- Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni; (Bashki , KKT)
- Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni; (Bashki , KKT)
- Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit; (Bashki , KKT)
- Leje për ndryshimin e funksionit (Bashki , KKT)
- Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues; (Bashki , KKT)
- Certifikatë përdorimi (Bashki , KKT)
- Leje ndërtimi për prishje ndërtimi ekzistues; (Bashki , KKT)
- Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit; (Bashki , KKT)
- Leje infrastrukture; (Bashki , KKT)

*Të aplikueshme vetëm për Bashkitë:*

- Deklaratë paraprake për kryerje punimesh (e aplikueshme vetëm pë Bashkitë pasi nuk aplikohet për objekte të cilat kalojnë për miratim në KKT)
- Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> (procedurë e përshpejtuar)
- Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup> (procedurë e përshpejtuar)
- Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>. (procedurë e përshpejtuar)
- Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me siperfaqe deri në 250 m<sup>2</sup> (procedurë e përshpejtuar)
- Leje ndërtimi për rikonstrukcion me ndryshim funksioni (procedurë e përshpejtuar)
- Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues;
- Njoftim për fillimin e punimeve;
- Njoftim për raportin e mbikëqyrjes
- Njoftim për raportin e kolaudimit;
- Leje ndërtimi, riparimi, restaurimi me procedurë të përshpejtuar për emergjencat civile.
- Aplikim për leje ndërtimi, riparimi, restaurimi, me procedurë të përshpejtuar për emernca civile

### **3.3. Koordinimi i punës nga AZHT**

Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) është institucioni që administron informacionin në sistemin elektronik të lejeve, në cilësinë e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit, që ka akses në sistemin elektronik të lejeve (*e-Leje*), në drejtim të verifikimit të dhënave parësore dhe dytësore që kjo bazë të dhënat grumbullon, si dhe të përmirësimit të procedurave që kryhen nëpërmjet sistemit elektronik.

Koordinimi i punës nga ana e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit kryhet duke ofruar:

- asistencë ligjore dhe procedurale ndaj bashkive dhe institucioneve të përfshira në sistemin *e-Leje*;

- trajnime, kur është e nevojshme, me kërkesë të autoriteteteve publike, stafin e bashkive dhe institucioneve;
- miratimin e listave dhe formularëve TIP të dokumentacionit që do të kerkohen nga autoritetet vendore, për aplikimet *online*, për çdo shërbim që ofrojnë, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, dhe vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar;
- protokolle pune mbi bazën e marrëveshjeve të shërbimit, për informacionin që do të ofrohet nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit apo/dhe institucionet e përfshira në sistemin *e-Leje*, për aplikimet *online*, për çdo shërbim që ofrojnë, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, dhe vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar;
- informacioni dhe suporti (*Help Desk*) për shërbimet që ofrohen nëpërmjet sistemit, në bashkëpunim me AKSHI-n.

### **3.4. Risi të e-Sistemit "e-leje"**

Implementimi i sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit ka bërë të mundur:

- Unifikimin e procedurave të aplikimit për 61 Njësi të Qeverisjes Vendore;
- Integrimin automatik në kohë reale midis sistemit e-leje me databaza të të gjitha institucioneve që janë pjesë e sistemit. Sistemi e-leje është konceptuar të integrohet me databazat e regjistrat të gjendjes civile, QKB, dhe ASHK (për pjesën e dixhitalizuar të pasurive të paluajtëshme),
- Përfshirjen në sistemin e-leje të sa më shumë institucioneve të cilat duhet të shprehen në lidhje me lejet e ndërtimit , duke thjeshtuar kështu dokumentacionin e aplikimit për leje. Pjesë e sistemit e-leje janë; Strukturat Teknike pranë çdo Ministrie, Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), Instituti Kombtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) , Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSh), 21 Drejtori rajonale dhe vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Instituti i Ndertimit (IN), 11

- Drejtori rajonale te OSHEE -se, Drejtori të Ujesjellës Kanalizime (59 drejtori), Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin - (MZSH) (48 Drejtori/stacione të ngritura ndërkokë që po strukturohen dhe 10 të tjera);
- Zbatimin e parimit të shërbimit me një ndalesë përmes ndërveprimit elektronik me të gjitha institucionet;
  - Dokumetet e lëshuara nga institucionet do të administrohen nëpërmjet sistemit më thjeshtë, më lehtë, më shpejtë;
  - Monitorimin e afateve të shqyrtimit të lejeve sipas legjisacionit në fuqi;
  - Zbatimin e miratimit në heshtje të lejes në rastet kur bashkia nuk reagon brenda 60 diteve nga marrja e aplikimit;
  - Rritjen e transparencës ndaj qytetarëve.

## 4. STRATEGJIA NË VAZHDIMËSI

---

### 4.1. Çfarë synohet të arrihet

Përfshirjen e sa më shume institucioneve, me të gjitha funksionalitetet në sistemin e-leje, duke bërë të mundur një koordinim më të mirë ndërinstitucional, shkurtim afatesh, kostosh dhe dokumentacioni për qytetarët, rritje transparence dhe shërbim me një ndalesë.

Në përputhje dhe zbatim të strategjisë dhe qëllimit të AZHT-së përfshirje të sa më shumë institucioneve në shërbimet online, në bashkëpunim me AKSHI-n është mundësuar, në janar të këtij viti, aplikimi, shqyrtimi dhe lëshimi i lejeve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, të bëhet online duke realizuar ndërveprim me lejet e zhvillimit/ndërtimit, duke arritur kështu zbatimin e plotë të parimit të shërbimit me një ndalesë.

Në këtë mënyrë çdo dokument që lëshohet nga institucionet shtetërore do të mund të administrohet brenda një sistemi, duke ulur barrën për aplikuesit dhe qytetarët, duke reduktuar kostot dhe kohën për të cilin kërkohet një shërbim.

Gjithashtu synohet rritja e bashkëpunimit me bashkitë dhe me institucionet e tjera përgjegjëse me qëllim monitorimin e zhvillimeve në territor, duke siguruar standarde në fushën e ndërtimit.

Në vijim, AZHT do të sigurojë një përmirësim të vazhdueshëm të kuadrit ligjor në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në kuadër të zbatimit të shërbimit me një ndalesë dhe sistemit online, si dhe do të propozojë përmiresimin e kuadrit ligjor sektorial, në mënyre që të arrihet harmonizimi i plotë me ligjin, dhe aktet nënligjore për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Agjencia do të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm dhe do të garantojë nevojat e brezave për barazi sociale, zhvillim ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore.

Gjithashtu, Agjencia merr angazhimin që lejet e zhvillimit/ ndërtimit të mos mbeten thjesht në kuadrin e kërkesave administrative, por të jenë pjesë veçanërisht e rëndësishme në rritjen e e zhvillimit ekonomik, në tërheqjen e investimeve dhe sigurimin e një mbrojtje më të drejtë për komunitetin. Rrjedhimisht, synohet jo vetëm përmirësimi dhe lehtësimi i procedurave, por edhe zhvillimi i territorit dhe ndërtimi në një mënyrë të shpejtë dhe eficiente.

## AKTIVITETET E MUNDSHME TË KONTROLLIT

Risqet e identikuara mund të zvogëlohen ose kufizohen nëpërmjet futjes së aktiviteteve të duhura të kontrollit. Këto mund të janë:

Kontrollet parandaluese të konceptuara për të reduktuar mundësinë e ndodhjes së riskut (të tilla si ndarja e detyrave, kufij të qartë të delegimeve të autorizuara);

Kontrolle korriguese të konceptuara për të korriguar rezultatet e padëshiruara (të tilla si rekuperimi i pagesave të pasakta);

Kontrolle Udhëzuese të konceptuara për të garantuar që një rezultat i veçantë është arritur (të tilla si masat e sigurisë apo kërkesat për ruajtjen e shëndetit dhe jetës);

Kontrolle Zbuluese të konceptuara për të identifikuar rastet kur rezultatet e padëshiruara tashmë kanë ndodhur (të tilla si kontolle të aktiveve, apo procedurat e rakordimit me Thesarin).

## **PARIMET E MENAXHIMIT TË RISKUT**

Parimet thelbësore në të cilat bazohet Strategjia e menaxhimit të Riskut janë si më poshtë:

- Menaxhimi i Riskut krijon dhe mbron vlerat;
- Menaxhimi i Riskut është pjesë integrale e proceseve të Institucionit;
- Menaxhimi i Riskut është pjesë e vendimmarrjes;
- Menaxhimi i Riskut i adresohet pasigurisë;
- Menaxhimi i Riskut është sistematik, i strukturuar dhe në kohë;
- Menaxhimi i Riskut bazohet në informacionin më të saktë të mundshëm;
- Menaxhimi i Riskut merr në konsideratë faktorët njerëzor dhe kulturor;
- Menaxhimi i Riskut është transparent dhe përfshirës;

## **PROCESI I MENAXHIMIT TË RISKUT**

Zhvillimet globale tregojnë se të gjithë sektorët e ekonomisë, dhe në mënyrë të vecantë sektori publik po fokusohet në menaxhimin e riskut si çelësi për të qenë të suksesshëm në ofrimin e objektivave.

Risku karakterizon çdo veprimtari që kryen njeriu në shoqëri, ekonomi, politikë, arsim shkencë, shëndetësi, rend, turizëm, infrastrukturë, etj. Çdo risk është specifik dmth ka natyrën e tij: përmasat, densitetin (i lartë, i mesëm, i ulët), ndikimin, masën e humbjeve (dëmtimeve), etj. Risku në sistem përcaktohet nga natyra e proceseve, objekteve dhe struktura (infrastruktura). Për të menaxhuar riskun në sistem, duhet bërë menaxhimi i proceseve eventualisht në objekte ose/edhe në strukturat përkatëse.

Risku është pasiguria e rezultatit, dhe një menaxhim i mirë i riskut lejon:

- Të rritet besimi në arritjen e rezultateve të dëshiruara
- Të trajtohen kërcënimet në mënyrë efektive në nivele të pranueshme; dhe
- Të merren vendime të informuara mbi shfrytëzimin e mundësive.

Menaxhimi i mirë I riskut bën të mundur që grupet e interest të rrisin besimin në qeverisjen organizative dhe përfshin të gjitha proceset si: identifikimi, vlerësimi dhe gjykimi i risqeve, si dhe ndërmarrja e veprimeve për parashikimin, zvogëlimin, minitorimin dhe eleminimin e tyre. Menaxhimi i mirë i riskut e sheh atë ne kompleks, risqet analizohen duke mos i parë ato si të izoluar por si risqe që ndërveaprojnë dhe mund te kene impakt te njëri tjetri. Ecuria e mirë e punës së Agjencisë së Territorit është e lidhur ngushtë me procesin e menaxhimit të riskut. Për identifikimin dhe analizën e riskut përdoret një metodikë e unifikuar dhe menaxhimi i tij azhornohet në varësi të akteve ligjore të Ministrisë së Financave.

Në kuadër të nevojës për menaxhimin me efikasitet të risqeve lidhur me zhvillimin e veprimtarisë së Institucionit drejtuesit e njësive të vecanta kanë për detyrë të monitorojnë dhe verifikojnë periodikisht risqet që kërcënojnë

realizimin e qëllimeve kryesore strategjike të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit. Personat që kanë përgjegjësi për menaxhimin e riskut duhet të kenë kualifikimin e nevojshëm dhe të kryejnë trajnime të vazhdueshme lidhur me identifikimin, vlerësimin dhe reduktimin e risqeve. Cdo punonjës i Institucionit ka për detyrim të raportojë cdo ngjarje si pozitive ashtu dhe negative për të siguaruar ecurinë e punës.

## KOMPONENTËT E MENAXHIMIT TË RISKUT INSTITUCIONAL

Menaxhimi i riskut institucional përbëhet nga 8 elementë që rrjedhin nga mënyra se si menaxhimi drejton dhe se si këta elementë janë të integruar me procesin e menaxhimit. Këta element janë si më poshtë:

- Ambienti i kontrollit

Përfshin filozofinë e menaxhimit të riskut, integritetin dhe vlerat etike, si dhe ambientin e ushtrimit të veprimtarisë, përshkruan gjithashtu kulturen e riskut dhe menyrën si ai identifikohet dhe adresohet në intitucion.

- Vendosja e objektivave

Vendosja e objektivave është hapi i parë mbas të cilit identifikohen faktorët që mund të influencojnë negativisht realizimin e tyre, pra risqet.

- Identifikimi risqeve

Duke identifikuar mjedisin e jashtëm që influencon realizimin e objektivave përcaktohen dhe mundësitetë dhe kërcenimet.

- Vlerësimi i risqeve

Vlerësohen gjasat që rishku të shfaqet si dhe impaktin që mund të ketë.

- Përgjigja/reagimi ndaj risqeve

Në momentin që një risk identifikohet dhe analizohet merren masa për shambahje, reduktim apo elemenimin e tij në mënyrë që të përmirësohet dhe të rritet besueshmëria e punës së institucionit.

- Veprimtaritë e kontrollit

Kontroll i vazhdueshëm i veprimtarisë së institucionit

- Informimi dhe komunikimi

Cdokush ka detyrimin qe të raportojë dhe informojë ne rastin e një ngjarjeje që mund të paraqesë një risk për institucionin

- Monitorimi

Monitorimi duhet të jetë i vazhdueshëm në cdo hallkë të institucionit për të bërë më të thjeshtë identifikimin e risqeve të mundshme.

## METODOLOGJIA E AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

### 1. Hartimi i planit vjetor të punës

Cdo vit, drejtoritë e institucionit miratojnë planin vjetor të punës i cili përcakton detyrat që duhet të kryhen me qëllim realizimin e qëllimit strategjik të institucionit në përputhje me kuadrin ligjor. Hartimi i planit të punës është një instrument i rëndësishëm që ndihmon në qartësimin e objektivave vjetore të se cilës drejtori.

### 2. Kodi i etikës

Të gjithë punonjësit e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit duhet të respektojnë regullat e etikës në Administratën publike, ligji 9131 "Për rregullat e etikës në administratën publike", përcaktuar në rregulloren e brendshme te AZHT si dhe në kontratën e cdo punonjësi. Etika e punonjësit ka të bëjë me respektimin e orarit zyrtar si dhe zbatimin e detyrës me përgjegjshmeri, integritet dhe përkushtim, nxitjen e punës ne grup, respektimin e diversiteteve si dhe inkurajimin e marrjes përsipër të përgjegjësive

### 3. Rregullorja e Institucionit

Është ne process miratimi rregullorja e institucionit e cila ka si qëllim përcaktimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të territorit, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e cdo punonjësi. Regullorja gjithashtu do të jetë një ndihmë për realizimin me sukses të detyrave të gjithsecilit, duke u mbështetur në parimet e profesionalizmit, integritetit, transparencës, qëndrueshmerisë, shërbimit për publikun si dhe respektimin e legjislacionit ne fuqi.

### 4. Hartimi i regjistrat të riskut

Cdo vit hartoher regjistri i riskut të institucionit ku evidentohen risqet sipas drejtorive. Kjo analizë ka për qëllim venien nëdukje të faktorëve që mund të ndikojnë negativisht ecurinë e punës dhe ndër faktorët që përmenden në register mund të jenë:

- Njohuritë e punonjësve në fushën e trajtimit dhe menaxhimit të riskut, kualifikimi i tyre
- Cilësia e dokumentacionit të preqatitjes së buxhetit
- Etika dhe integriteti i punonjësve
- Problemet e mundshme mes pronës dhe zhvilluesit të territorit
- Interpretimi në mënyrë jo korrekte i dispozitave ligjore në fuqi lidhur me zhvillimin e territorit.

## **FAKTORËT, LLOJET DHE PROBABILITETI I RISKUT**

Faktorë të ndryshëm mund të ndikojnë në lindjen e një risku që mund të kushtëzojë apo pengojë arritjen e rezultateve te dëshiruara ne Institucion. Disa prej tyre mund të jenë:

- Dështimet në arritjen e qëllimeve në të kaluarën, mosrealizimi I detyrës, tejkalimi I shpenzimeve të planifikuara, cënimi I procedurave, shkelja e ligjit, e rekomandimeve të KLSH apo të Auditit të brendshëm
- Numri I punonjësve, specifikat e territorit ku zhvillohet aktiviteti
- Ndryshimet politike dhe politikat globale
- Politikat ekonomike Kombëtare dhe aftësia e burimeve financiare për arritjen e objektivave
- Ndryshimet demografike apo social-kulturore
- Politikat qeveritare të mbrojtjes së ambjentit

Duke marrë parasysh faktorët që mund të ndikojnë në shfaqjen e një risku mund të themi se risku I shfaqqür mund të ketë natyra të ndryshme, ai mund të jetë:

- I lartë: kur zgjidhja e problemit kërkon shumë kohe dhe burime dhe shmangja e pasojave mund të jetë e vështirë
- I mesëm: kur zgjidhja e problemit kërkon kohe mesatare dhe shmangja e pasojave mund të kerkaje kohë por mund të realizohet
- I ulët: Zgjidhja e problemit mund të kerkojë kohë por problem nuk shkakton dëme të përhershme

Përsa I përket probabilitetit që një risk të shfaqet, ai mund të konsiderohet I lartë kur risku ka më shumë se 60 % probabilitet, I mesëm kur gjasat janë nga 20 % te 60 % dhe I ulet kur gjasat që risku të shfaqet janë me pak se 20 %.

## **REAGIMI NDAJ RISKUT**

Së pari është e rëndësishme jo vetëm të identifikohen risqet, por edhe të ketë një kontroll të vazhdueshëm mbi to për të parë nëse dinamikat e riskut kanë ndryshuar, janë shfaqur risqe te reja apo janë eleminuar risqet ekzistuese. Cdo vit hartohet regjistri i riskut i cili ndihmon drejtuesin e institucionit po edhe drejtuesit e drejtorive që të adresojnë me mirë punën, strategjitet për të zhvilluar detyrat me sa më shumë efikasitet dhe përgjegjshmëri. Grupi i Menaxhimit Strategjik ka përgjegjësinë që të ngrejë strukturat përmarrjen e vendimeve konkrete në cdo rast. Risqet lidhen ngushtë me objektivat prandaj cdo herë kur vendoset një objektiv i ri duhen përcaktuar mire risqet që lidhen

me tē nē mënyrë që tē mos ketē gabime nē përcaktimin e strategjive. Nē rastin e shfaqjes së risqeve tē vogla, me probabilitet tē ulët pér tu shfaqur por edhe që smund tē influencojnë arritjen e objektivave tē Institucionit mund tē vendoset tē mos merret asnjë masë, pra tē pranohet risku Nē momentin që evidentohet një risk analiza e parë shkon te burimet njerëzore dhe veprimtaria e tyre. Duke qenë se ai risk mund te paraqitet edhe nē tē ardhmen dhe te sjellë humbje pér institucionin duhet që tē merren masa pér kufizimin e tij. Aktiviteti që mund tē ndërmerret është ndarja e mirë e detyrave tē stafit, por edhe mbikqyrja dhe kontrolli i vazhdueshëm i tyre.

Gjithashtu zhvillohen takime tē vazhdueshme pér cështjet e buxhetit duke bërë analizën e raporteve dhe rakordimeve me drejtorinë e thesarit, pér tē kontrolluar shfrytëzimin efektiv tē burimeve financiare.

Në rast tē shfaqjes së riskut nē veprimtarinë e kontrollit tē tē dhënavë si psh aksesimi I paautorizuar i një faktori tē jashtëm automatikisht sinjalizohet te sektori I IT i cili ndërhyn nē bllokimin e tē drejtave pér tē marrë, fshirë apo rishkruajtur një dokument ne rrjetin e Intitucionit.

Një masë parandaluese pér risqet tē tipit mashtime, tejkalime tē përgjegjësisë apo mungesën e bashkëpunimit mund tē jetë organizimi i mirë dhe alokimi I përgjegjësive sipas pozicionit tē punonjësve, përcaktimi I niveleve tē autoritetit, ndarja e qartë e detyrave pér tē shmangur abuzime dhe mënyra e raportimit.

Në disa raste Institucioni mund tē heqë dorë nga realizimi I disa objektivave nëse risku që këto objektiva përfshijnë është tepër I lartë, nē raste tē tjera mund tē vendosin tē transferojnë riskun pér një menaxhim më tē mirë tē tij, nē këtë rast duhet tē ketë bashkëpunim me palën e tretë tē cilës i transferohet risku.

## RISHIKIMI I RISKUT

Menaxhimi I Riskut mund tē rishikohet dhe raportohet pér 2 arsyë:

- Pér tē monitoruar nëse profile I riskut ka ndryshuar
- Per tu siguruar që menaxhimi I riskut është efektiv dhe pér tē identifikuar se kur është I nevojshëm veprimi I mëtejshëm.

Proceset rishikuese kanë funksionin tē kontrollojnë nëse risku ekziston akoma, nëse është rritur, nëse ndikimi I tij është I njëti apo ka ndryshuar. Cdo vit dorëzohet pranë Ministrisë së Financave raporti I vetëvlerësimit ku Institucioni angazhohet tē bëjë një pasqyrë tē situatës ekzistente dhe tē vlerësojne risqet.

## **INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI**

Menaxhimi i riskut të Agjencisë Së Zhvillimit Të Territorit kërkon që Institucioni të ketë informacion të detajuar për arritjen e objektivave që mundte jetë informacion I tipit historik, pra analiza e arritjeve aktuale kundrejt objektivave, të dhena aktuale që lejojnë një pamje në kohë relae të risqeve ekzistuese, si dhe të dhëna që kanë të bëjnë me të ardhmen, tendencat të cilat mund të janë një ndihmesë për të identifikuar dhe vlerësuar risqet e mundshme, impaktin e tyre dhe vlerësimin e një menaxhimi sa më të mirë të tyre në mënyrë që të mos pengohet securia e punës së Institucionit dhe arritja e objektivave te tij.